



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d) dhe 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 17 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, nenit 17 të Rregullores QRK nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të nenit 15 parag. 2.4, dhe nenin 17 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 08 prill 2021, miratoi këtë,

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës të paluajtshme të Komunës - Lokal në qytetin e Podujevës

Neni 1

Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës sipas vendimit nr.prot.01-463/02-0031685/21 datë 08 prill 2021 përkatës për miratim paraprak të vendimit për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik, pronën e paluajtshme të Komunës – Lokal në qytetin e Podujevës (*ish Lokali i Shërbimit të Kontabilitetit Shoqëror në sheshi i qytetit*), në këtë përbërje:

1. **Elhame Kutllovci**, nga Ekzekutivi i Komunës
2. **Bahri Selimi**, nga Ekzekutivi i Komunës
3. **Shaban Bajoku**, nga Kuvendi i Komunës
4. **Fatmir Rudari**, nga Kuvendi i Komunës
5. **Genc Rashiti**, nga sektori joqeveritar lokal

Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni i cili organizon dhe kryeson punën e komisionit.

Neni 2

Mandati i komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, përkatësisht për zbatimin e vendimit nr.prot.01-463/02-0031685/21 të Kuvendit të Komunës për miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës të paluajtshme të Komunës të datës 08 prill 2021.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe Rregulloren QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Drejtoritë dhe shërbimet tjera përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.01-463/02-0031716/21
Podujevë, 08 prill 2021

Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi